



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR
NJESIA E PROKURIMIT**

Dibër, më 18.03.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: Rehabilitim dhe ndertim i kanaleve vaditese 2024

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pune ndertimi (45100000-7).

VLERA E FONDIT LIMIT: **16.666.667 (Gjashtembedhjete milion e gjashteqind e gjashtedhjete e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhjete e shtate leke pa TVSH.**

Argumentimi : Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar në preventivin e hartuar mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor _____ (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021,2022,2023) të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, mbi bazën e të cilave, AK mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore : Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022,2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së parashikuar të kontratës që po prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë : Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet : - vlerën e parashikuar të kontratës,

në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, bazuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023. *Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2023, sipas të dhënave të QKB-së*

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerësimit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore perkatese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës se fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- NP-1 A Punime gërmimi në tokë.
- NP-7 A Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
- NP- 12 A Punime te inxhinierise se mjedisit

Për punimet special të ndërtimit :

- NS-18 A Punime topogjeodezike

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

4. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “ Grumbulim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe dhera si mbetje te parrezikshme ” . Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 “Per disa ndyshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat,autorizimetdhe lejet ne Republiken e Shqiperise”)Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim nr.538, datë 26.5.2009 “Për

licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë një punësim mesatar i të paktën 50 (pesedhjetë) personave, të cilët duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:
- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
 - Listepagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim: Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore Nëpërmjet këtij kushti kërkohej që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të t’i dhënë garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, si dhe kohëzgjatjen e saj. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listepagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për periudhën 3 muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i

punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

6. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik drejtues teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën për 3 (tre) muajt e fundit, konkretisht;

- a) 1 (një) Inxhinier Ndertimi
- b) 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- c) 1 (një) Inxhinier Topograf

Për inxhinieret drejtues teknik si mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme
- Diplomë;
- Librezë pune;
- CV

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve: ndërtimi, hidroteknik, gjeodet/topograf është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi

dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

7. Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar si staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar e kontrate pune te vlefshme, pajisur me diploma/certifikata te formimit profesional leshuar nga autoritete pergjegjese te akredituara/licensuara si dhe deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- 1 (nje) punonjes Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) punonjes teknik Hidraulik
- 1 (nje) punonjes teknik Ndertimi
- 1 (nje) punonjes teknik topograf
- 1 (nje) punonjes muratore
- 1 (nje) punonjes suvatues
- 1 (nje) punonjes bojaxhi
- 2 (dy) punonjes saldator
- 2 (dy) punonjes hekurkthyes
- 1 (nje) punonjes hekurpunues
- 4 (katër) punonjes karpentiere
- 2 (dy) punonjes betonues
- 4 (kater) punonjes manovrator
- 2 (dy) punonjes shofera

Për keta punonjes, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument (diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.
- certifikate te sigurimit teknik leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
- Për punonjesit e krahut , ofertuesi duhet të paraqesë kontratën individuale të punës te vlefshme .
- Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë: kontratën individuale të punës te vlefshme; leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8,

bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licencuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriter elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar personel të kualifikuar/ certifikuar shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/ certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë Gusht 2023 të paktën;
- 1 (një) punonjës që të disponojë Çertifikatën e trajnimit si "*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*", në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores "Për sigurinë në kantier"Ose kontratë shërbimi me subjekte private të licensuara për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.
 - ose
 - 1(një) punonjes i pajisur me certifikate "*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*" e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë,

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "ç".

Në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*“, sipas të cilit: „*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“. "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. Bazuar dhe ne V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për shkak të natyrës së punimeve që kryhen të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidente me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e **1(një) punonjes Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave.**

9. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues minimumi 3 (tre) muajt e fundit ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të licensuar, sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në nenin 3, pika 3, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", Ligjin Nr.10237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" (i ndryshuar), VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë" (i ndryshuar) i cili përcakton "2/1. Pundhësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndermarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike dhe12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndermarrjes është e detyrueshme për ato ndermarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës ... Mjeku i ndermarrjes ofron keshillimin e tij për problemet e mbrojtjes në punë, për shmangien e aksidenteve dhe të semundjeve profesionale, si dhe për të gjitha ceshtjet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai vlerëson ceshtjet fiziologjike të punës, të problemeve higjienike e sanitare, veçanërisht të ritmit e të kohës së punës, të organizimit të vendit të punës, të zhvillimit dhe të mjediseve të punës.

10. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet një leter/ akt marreveshje angazhimi midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (Tuba PE dhe HDPE SN 8). Për materialet e kërkuara operatorët ekonomikë duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit, certifikatat e cilësive ose deshmi të testeve zyrtare me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike

Argumentim: Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kërkesë është kërkuar që të sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomikë fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësi e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomikë plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësive ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike .Duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve e gjujkojme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më

të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesen e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në menyre të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me certifikatë konformiteti CE/certifikate cilesie etj. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilesie, certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotësimi i kërkesës garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjive të reja dhe bashkëkohore.

II. Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatën të vlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë të përcaktuara si më poshtë:

Certifikatë ISO 9001: - Certifikim për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte europiane e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO-mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kësaj ISO;

Certifikatë ISO 14001: - Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit ose ekuivalente (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kësaj ISO.

Certifikatë ISO 45001: - Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë ose ekuivalente, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kësaj ISO.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “d” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e*

Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001: është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001: me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001: ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001, ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001- është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001- me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

12. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Lloji i makinerive/pajisjeve	Statusi	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 15 ton	Ne pronesi ose me qira	1(nje) cope
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes deri ne 12 ton	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
3	Kamion vetshkarkues me vinç	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
4	Ekskavator me zinxhirë me krahë të gjatë mbi 18 m	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
5	Ekskavatore me zinxhire	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
6	Miniekskavatore me zinxhire	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
7	Minifadrome	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
8	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
9	Vibrator thellesie	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
10	Matrapik	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
11	Nivelues betoni	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope

12	Gjenerator	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
13	GPS base+rover	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
14	Armatura betoni	Ne pronesi ose me qira	100 m2
15	Karroca dore	Ne pronesi ose me qira	10 (dhjete) cope
16	Lopata	Ne pronesi ose me qira	10 (dhjete) cope
17	Kazma	Ne pronesi ose me qira	10 (dhjete) cope
PAJISJE MBROJTSE			
Kokore		50 copë	
Jeleke		50 copë	
Kuti te ndihmës së shpejtë		5 cope	
Tabela sinjalistike mbrojtse		15 cope	

Shenim: Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:

- a) Për makineri teknologjike dhe mjete që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: çertifikatë pronësie, leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, siguracionin;
- b) Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- c) Për makineri teknologjike dhe mjete që nuk shënohen në regjistra publikë (makineritë teknologjike), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.
- d) Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimi ose faturë tatimore blerje) dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- e) Për paisjet kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontratë blerje/faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje.
- f) Ndërsa për paisjet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur fature zhdoganimi/fature tatimore blerje) e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.
- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilën makineri teknologjike dhe mjete dhe paisje të deklaruar.
- h) Për makineritë teknologjike dhe mjetet, fotoja duhet të ketë të dallueshme edhe targën e mjetit.
- i) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues.
- j) Per Fabrikat e prodhimit te betonit/asfaltit/inerteve OE duhet te paraqesin kontratë furnizimi (Kontrata Noteriale e Qerasë/Furnizimit duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate)

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika

6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre". Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit). Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër eshte kerkuar ne funksion te kryerjes se zerave specifike te punimeve, ndërsa numri i mjeteve eshte percaktuar ne varesi te volumeve dhe grafikut te punimeve pra verteton se ofertuesi i mundshem zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

13. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- ❖ Analize teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3 "Autoriteti Kontraktor ne dokuemntat e tenderit parashikon me grafik,fazat dhe afatet e realizimit te puneve"

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin...", sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit do t'i kërkojë ofertuesit te kualifikuar i pari nëpërmjet Sistemit të

Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjesve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike: janë sipas projektit të zbatimit të hartuar nga projektuesi dhe marrë në dorëzim nga grupi i punës përkatës për marrjen në dorëzim të projektit me dokumentacionin teknik të tij, duke iu përmbajtur parashikimeve të nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Shënim: Në të gjitha rastet në specifikime teknike ose preventiv ku mund të jenë përmendur markë specifike apo emërtim AK ka parashikuar se do të pranohen edhe ekuivalentët e tyre.

Shënim: Në të gjitha rastet ku në Dokumentat e tenderit, specifikimet teknike ose preventiv përmenden standarte ndërkombëtare Ak, ka parashikuar se do të pranohen edhe standartet kombëtare të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).

Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT